



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 1377/9 Prot.

Tiranë, më 08.11.2017

V E N D I M

Nr.225, datë 08/11/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 183, datë 28.07.2017, "Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunës **"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 183, datë 28.07.2017, "Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunës *****",

Vërej se:

Me Urdhrin nr. 1377/1 prot., datë 18.07.2017, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së veprimit administrativ përfunduar me aktin nr. 191, datë 05.06.2017, "Për transferim të përkohshëm", të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 183, datë 28.07.2017, "Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunës *****", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në pikat 1 dhe 2 të të cilit është vendosur:

"1. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë, të anulojë aktin administrativ nr. 191, datë 05.06.2017, të nxjerrë prej tij, "Për transferimin e përkohshëm të punonjës **", si një akt i dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të rregullojë pasojat, duke e rikthyer punonjësen në pozicionin e mëparshëm të punës.***

2. *Bashkia Kolonjë, të zbatojë vendimin brenda 15 ditëve nga data e marrjes dijani dhe pas përfundimit të këtij afati, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për zbatimin e vendimit.*”

Me kalimin e afatit procedural të parashikuar në pikën 2, të Vendimit Nr. 183, datë 28.07.2017, “*Mbi verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses ******”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Bashkia Kolonjë me shkresën nr. 2421 prot., datë 11.08.2017, “*Dërgohet informacion*”, ka njoftuar Komisionerin në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna në dispozitivin e vendimit.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Në pikën 1 të vendimit objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Kolonjë të anulojë aktin e transferimit të përkohshëm të nëpunëses *****, si një akt i dalë në kundërshtim me ligjin dhe të rikthejë punonjësen në pozicionin e mëparshëm të punës.

Kryetari i Bashkisë Kolonjë, me Vendimin Nr. 8, datë 11.08.2017, ka vendosur shfuqizimin e aktit nr. 191, datë 05.06.2017, “*Për transferimin e përkohshëm të punonjëses ******” dhe rikthimin e saj në pozicionin e mëparshëm të punës “*Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore*” (duke bërë edhe rregullimin e marrëdhënies financiare gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm).

Pavarësisht se tashmë marrëdhënia *de facto* është rregulluar, pasi punonjësjë në fjalë është kthyer në pozicionin që mbante përpara transferimit, *de jure* akti i shfuqizimit, Vendimi Nr.8, datë 11.08.2017, i Kryetarit të Bashkisë Kolonjë është nxjerrë në kuptim të gabuar të ligjit, konkretisht nenit 114, “*Anulimi dhe shfuqizimi diskrecionar i një akti administrativ të paligjshëm*”, të Ligjit Nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, në të cilin parashikohet sa më poshtë vijon:

“1. *Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 108 (“Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”), të këtij Kodi, një akt administrativ i paligjshëm mund të anulohet apo të shfuqizohet, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë.*

2. *Nëse pala përfituese është në mirëbesim, një akt administrativ dobiprurës i paligjshëm, nuk mund të anulohet, por vetëm mund të shfuqizohet.*

3. *Pala përfituese nuk vlerësohet se është në mirëbesim nëse ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit ose nuk ka qenë në dijeni të tyre për shkak të pakujdesisë së rëndë apo nëse akti është nxjerrë bazuar në informacionin materialisht të gabuar apo jo të plotë të dhënë, me faj, nga vetë pala.”*

Nga përmbajtja e këtij neni rezulton se akti administrativ i paligjshëm mund të: 1) anulohet ose 2) shfuqizohet.

Në pikën 2 të dispozitës më sipër përcaktohet se në ç'rast mund të procedohet me anulimin e një akti administrativ të paligjshëm dhe në ç'rast me shfuqizimin e tij. Konkretisht, shfuqizimi mund të përdoret vetëm në rast se pala përfituese është në mirëbesim.

Më tej, në pikën 3 përcaktohet qartazi se kur do të konsiderohet se pala përfituese është në mirëbesim. Pala përfituese do të vlerësohet se ka qenë në mirëbesim nëse, ndër të tjera, nuk ka qenë në dijeni të shkaqeve të paligjshmërisë së aktit. Ndërkohë, nga ankimi që punonjësja ***** ka paraqitur pranë Komisionerit (*protokolluar me nr. 1377 prot., datë 13.07.2017*), ka rezultuar se punonjësja nuk ka qenë dakord me transferimin që i është bërë pranë njësisë administrative “Çlirimi”, duke e konsideruar këtë lëvizje si të pabazuar në ligj. Çka do të thotë se ajo nuk ka qenë në mirëbesim dhe për këtë arsye, akti i paligjshëm i transferimit të saj nuk mund të shfuqizohej, por vetëm të anulohet, duke i shtrirë pasojat edhe në të shkuarën, sikundër është shprehur Komisioneri në pikën 1 të vendimit nr. 183, datë 28.07.2017, objekt i këtij verifikimi.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 183, datë 28.07.2017, “*Mbi verifikimin e ligjshërisë së aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses ******”, të Komisionerit, rezulton se nga ana e institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues. Sikundër është argumentuar më sipër, për rikthimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, Kryetari i Bashkisë Kolonjë duhej të kishte anuluar aktin e transferimit të punonjësës V. Fane dhe jo ta shfuqizonte atë. Megjithatë, kjo parregullsi duhet të kihet parasysh që të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, si dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 183, datë 28.07.2017, “*Mbi verifikimin e ligjshërisë së aktit nr. 191, datë 05.06.2017, të Kryetarit të Bashkisë Kolonjë, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses ******”.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit, Bashkia Kolonjë, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 183, datë 28.07.2017.

3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Kolonjë dhe nëpunësja
*****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA